



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:028108

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05725415

AA.nr.708/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, S.H nga Fusha Kosova, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.409/2020, të datës;15.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.409/2020, i datës;15.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.409/2020, të datës;15.08.2023, është vendosur, “*I. APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditëses S.H si e bazuar. II. ANULOHEN vendimet të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve me numër të dosjes 6004165 të dt.17.10.2019 dhe të dt.11.05.2017 dhe paditëses S.H i njihet e drejta në pensionin e paaftësisë së përhershme nga dt.01.07.2023 deri me datë 01.07.2028. III. DETYROHET e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, që paditëses S.H, t'ia kompensojë në mënyrë retroaktive pagesën në emër të pensionit të paaftësisë së përhershme për periudhën nga data e parashtrimin të kërkesës me dt.14.05.2017 e deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare me dt.22.06.2023 dhe atë: shumën e përgjithshme prej 5.941.87 euro (pesë mijë e nëntëqind e katër dhjetë euro e tetëdhjetë e shtatë cent), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. IV. Udhëzohet paditësja që pas 5 (pesë) viteve nga momenti i njohjes së kësaj të drejte për të ardhmen, të paraqesë kërkesë për rivlerësim mjekësor tek e paditura, për të vazhduar njohjen e kësaj të drejte. V. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anulura. VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi A.nr.409/2020, të datës;15.08.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të prishet, dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës i datës;17.10.2019 dhe i datës;11.05.2017.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësja.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të paditurës dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;18.02.2020, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet kundërshtuar me padi janë të pa bazuar dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që të njëjtit të anulohen në tërësi, si dhe t'i njihet e drejta në pension për personat me paaftësi të kufizuar.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar. E paditura, me vendimin me numër të dosjes 6004165 të dt.17.10.2019, ia ka refuzuar ankesën, tani paditëses S.H, si të pabazuar. E pakënaqur me këtë vendim, paditësja S.H, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.25.02.2020, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit. Nga vendimet e kontestuar del se ato përmbajnë të meta, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47.1.3 dhe nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajnë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar, respektivisht në nenin 48 parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit, ndërsa, nëse është i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Vendimi i të paditurës, është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë*

kushtëzuar në marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: “Duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë A.nr.1805/2017 të dt.05.07.2019, në lidhje me padinë e znj. S.H, gjegjësisht komisioni mjekësor me ekspertë të lëmive përkatëse në seancën e dt.26.09.2019, në mënyrë të gjithanshme përsëri ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor dhe vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë në përputhje me nenin 9 të ligjit të cekur më lartë dhe ka konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me paaftësi të përhershme, prandaj komisioni mjekësor i caktuar enkas në ri procedurë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë që nuk janë plotësuar kriteret për Pak dhe konform kësaj ankesën e refuzon si të pabazuar. Organi i shkallës së dytë ka vlerësuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar në plotëni dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe etikën mjekësore duke konstatuar se parashtruesi i ankesës nuk i përmbushë kriteret e parashikuara me Ligjit për Pak dhe në bazë të vlerësimit të komisionit mjekësor të shkallës së dytë vendosi që ankesën ta refuzoj në pajtim me nenin 9 të Ligjit 04/L-131”. Kjo gjykatë pas administrimit të provave si më lartë, pasi i ka vlerësuar një nga një provat dhe të gjitha së bashku, ia fali besimin raporteve mjekësore për paditësen si dhe ekspertizës mjekësore të dt.28.04.2023, e nxjerrë në përbërje prej tre (3) profesionistëve mjekësor: Dr. A.B – kirurg torakal, Dr. A.P – kirurg torakal dhe Dr. B.Gj - onkolog, të cilët pasi kanë ekzaminuar pacientin/paditësen, shkresat e lëndës, kanë nxjerrë përfundim/mendim profesional se pacienti/paditësja S.H, me dg: Carcinomes Duktave Invasive të gjirit të majtë (G III, T2 N2 M0) dhe gjendje pas Mastektomise radikale të modifikuar të majtë, të realizuar në nëntor në vitin 2011 nuk ka shenja kliniko-radiologjike për recidiv lokal (përsëritje) të sëmundjes dhe nuk ka shenja për metastazë lokale dhe të largët në organizëm. Komisioni ka vlerësuar se pacientja në fjalë është me aftësi të kufizuar për punë të pacientëve me mastektomi radikale të njëanshme pas moshës 50 vjeçare është 20%, sipas tabelës mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor pika 5.1.3 nën b). Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.15.06.2023, kanë qenë prezentë ekspertët mjekësor: Dr. A.B – kirurg torakal, Dr. B.Gj - onkolog. Dr. A.B – kirurg torakal, ka deklaruar në emër të grupit të ekspertëve, mbeten në tërësi si në ekspertizën e dhënë me shkrim, pas ekzanimimit të drejtpërdrejtë me pacienten mendimi përfundimtar është se paditësja është me paaftësi të përhershme për punë. Pacientja duhet të jetë në kontroll të përhershëm. Në këtë kuptim dhe në bazë të provave në shkresat e lëndës, konkretisht raporteve mjekësore dhe ekspertizës mjekësore, si dhe deklarimit të ekspertëve mjekësor në seancë, gjykata konstaton se tek paditësja ekziston paaftësia e përhershme. Andaj, konform Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti i cili përcakton kriteret për përfitimim dhe drejtës në pension për persona me paaftësi të përhershme, gjykata ka ardhur në përfundim dhe ka vlerësuar që paditëses t’i njihet e drejta në pension e paaftësisë së përhershme nga data e parashtrimit të kërkesës me dt.14.05.2017 e deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare me dt.22.06.2023 si dhe kompensimin si në pikën III., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa nga data 01.07.2023 e deri 01.07.2028, gjykata i njohu për të ardhmen të drejtën në pension të paaftësisë së përhershme sipas shumës për këtë kategori. Për të gjitha këto arsye kjo gjykatë nuk mundi t’ia falë besimin mendimit dhe konstatimit të komisionit mjekësor të të paditurës të dhënë në vendimin e datës 26.10.2019, si provë e vetme e që vërteton se paaftësia e përhershme nuk ekziston. Sipas nenit 9 paragrafët 1 dhe 5 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është përcaktuar që: “Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës”; “Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me paaftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson

paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.” Pasi që gjykata vërtetoi këtë fakt mbi bazën e dokumenteve mjekësore dhe ekspertizës mjekësore në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, vlerësoi se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës duke marr për bazë këtë, konform nenit 43. par.3 të LKA-së, ka konstatuar se vendimi kontestues është i kundërligjshëm. Andaj, si rezultat i kësaj ka vendosur që paditëses t'i njihet e drejta në pensionin për persona me paaftësi të përhershme nga data e parashtrimit të kërkesës me dt.14.05.2017 e deri me nxjerrjen e ekspertizës financiare me dt.22.06.2023, pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar me parashtrimin e kërkesës për njohjen e pensionit për persona me paaftësi të përhershme te e paditura. Gjykata po ashtu vlerësoi se për shkak të gjendjes shëndetësore, të përshkruar nga ekspertët mjekësor, se paditësja është e paaftë për punë dhe se paaftësia saj është e përhershme, nga këto arsye paditëses ia njohu të drejtën në pensionin e paaftësisë se përhershme për të ardhmen, për periudhën prej pesë (5) viteve, nga data 01.07.2023 e deri me dt.01.07.2028. Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejte të gjendjes faktike, lidhur me pensionet që do t'i kishte realizuar paditësi nga zbatimi i vendimeve të kundërligjshme, në seancën e dt.15.06.2023, ka aprovuar propozimin e paditëses për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, e cila është hartuar nga ekspertja financiare M.B me datë 22.06.2023, të cilës gjykata ia fali besimin në tërësi, e cila në bazë të përlllogaritjeve të bëra ka ardhur në përfundim se shuma e papaguar dhe e perealizuar e pensionit të paditëses nga data e parashtrimit të kërkesës me dt.14.05.2017 e deri me në nxjerrjen e ekspertizës financiare me dt.22.06.2023 është: shuma e përgjithshme prej 5.941.87 euro (pesë mijë e nëntëqind e katër dhjetë një euro e tetëdhjetë e shtatë cent). Paditësja udhëzohet që pas kalimit të periudhës prej pesë vite duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të komisionit mjekësor pranë të paditurës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës, si në përgjigje në padi, lidhur me pabazueshmërinë e padisë, por në mungesë të argumentimit të tyre nga paditura, i vlerësoi të pabazuara dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e kësaj gjykate bazuar edhe në ekspertizën mjekësore.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPK-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk

vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e nxjerrë nga Gjykata sipas detyrës zyrtare të datës;28.04.2023, e cila është përgatitur nga mjekë specialist të SHSKUK-së në Prishtinë, Dr. A.B-Kirurg torakal, Dr. A.P-Kirurg torakal, dhe Dr. B.G-Onkolog, të cilët pasi kanë ekzaminuar pacientin/paditësen, shkresat e lëndës, kanë nxjerrë përfundim/mendim profesional *“se pacienti/paditësja S.H, me dg: Carcinomes Duktave Invasive të gjirit të majtë (G III, T2 N2 M0) dhe gjendje pas Mastektomise radikale të modifikuar të majtë, të realizuar në nëntor në vitin 2011 nuk ka shenja kliniko-radiologjike për recidiv lokal (përsëritje) të sëmundjes dhe nuk ka shenja për metastazë lokale dhe të largët në organizëm. Komisioni ka vlerësuar se pacientja në fjalë është me aftësi të kufizuar për punë të pacientëve me mastektomi radikale të njëanshme pas moshës 50 vjeçare është 20%, sipas tabelës mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor pika 5.1.3 nën b).* Kurse në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.15.06.2023, kanë deklaruar *“se mbeten në tërësi si në ekspertizën e dhënë me shkrim, pas ekzanimimit të drejtpërdrejtë me pacienten mendimi përfundimtar është se paditësja është me paaftësi të përhershme për punë. Pacientja duhet të jetë në kontroll të përhershëm.”* Ndërsa këtë ekspertizë nuk e ka kundërshtuar e paditura edhe pas dërgimit të saj me thirrjen për seancën e shqyrtimit të datës;15.06.2023, e as që ka marrë pjesë në seancë për ti kundërshtuar përfundimet e nxjerra nga ekspertet mjekësor. Prandaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i apelit vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore.

Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadsisë së aprovuar drejtë është vendosur duke u bazuar në ekspertizën e nxjerrë me propozim të paditësit të përgatitur nga ekspertja financiare, M.B e datës;22.06.2023, e të cilën ekspertizë nuk e ka kundërshtuar e paditura, edhe pas dorëzimit të saj me dt.14.07.2023. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë edhe në drejtim të lartësisë së kërkesëpadsisë së aprovuar si në pikën tre të dispozitivit të aktgjykimit.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoj, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, e cila eventualisht do ta vërtetonte të kundërtën nga ajo që është dhënë në ekspertizë. Prandaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit dhe se e njëjta drejtë ka zbatuar dispozitat Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenin 9 të tij, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të kontestuar.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje, faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë, ngase aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke marrë parasysh se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me

rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, në këtë kuptim ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.708/2023, datë;20.05.2023

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti